



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 30.04.2021

RAPORT
PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT
NR. 13037, DATË 19.04.2021,
“PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 48/2021 “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 25/2019
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISË GJYQËSORE””

-Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 30.04.2021 shqyrtoi Dekretin e Presidentit nr. 13037, datë 19.04.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 48/2021 “Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore””.

Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore””, u miratua nga Kuvendi në seancën e datës 23 mars 2021.

Bazuar në nenin 85 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës ka depozituar pranë Kuvendit, dekretin nr. 13037, datë 19.04.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 48/2021 “Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore””.

Komisioni për Çështjet Ligjore e shqyrtoi Dekretin e Presidentit nr. 13037 date 19.04.2021 bazuar në nenin 86 të Rregullores së Kuvendit.

Bazuar në nenin 26, pika 7, të Rregullores së Kuvendit, ky dekret u përfshi automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

I. BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.
2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.
3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.
4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.
5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.
6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsyet e kthimit të tij.
7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.
8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që Komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.
9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.

II. DISKUTIMI I DEKRETIT TË PRESIDENTIT NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE

Në mbledhjen e Komisionit për shqyrtimin e Dekretit ishin të pranishëm z. Bledar Dervishaj si përfaqësues i institucionit të Presidentit të Republikës, si dhe Z. Besmir Beja, përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë.

Përfaqësuesi i institucionit të Presidentit, paraqiti në mënyrë të përmbledhur argumentet për kthimin për rishqyrtim për kthimin e ligjit nr. 48/2021 “Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore””.

Në vazhdim të diskutimit, relatorja znj. Elena Xhina dhe anëtarë të Komisionit paraqitën opinionin e tyre lidhur me argumentet e paraqitura nga Presidenti i Republikës në Dekret. Lidhur me çështjet e ngritura në Dekretin e Presidentit të Republikës, argumentet dhe vlerësimet jepen më poshtë.

III. ARGUMENTET E PARAQITURA NË PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT NR. 13037, DATË 19.04.2021, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 48/2021 “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 25/2019 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISË GJYQËSORE””, SI DHE VLERËSIMI I TYRE NGA RELATORJA:

Pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura në Dekretin e Presidentit nr.13037 datë 19.04.2021, konstatohet dhe vlerësohet se:

1.Argumentet e Dekretit të Presidentit janë argumente që nuk kanë lidhje me projektligjin dhe efektet e tij por më shumë jepen si opinione të Presidentit me karakter politik mbi mënyrën se si Presidenti e percepton ose dëshiron ta perceptojë veprimtarinë e institucioneve të reformës në drejtësi; aspak në referim me objektivat e reformës në drejtësi dhe institucioneve kryesore në implementimin e suksesshëm të kësaj reforme shumë të nevojshme dhe të dobishme për proceset integruese të vendit në raport me pritshmëritë e shqiptarëve në kërkim të drejtësisë së munguar.

2.Për sa i takon Komisionit për Çështjet Ligjore, detyra e tij është të shqyrtojë argumentet e Presidentit vetëm për çështjet që kanë të bëjnë me dispozitat e ligjit nr.48/2021 dhe jo të adresojë opinionet politike të përcjellura në dekretin e Presidentit të cilat nuk kanë lidhje me dispozitat e ligjit nr. 48/2021.

3.Ligji është hartuar nga një grup i posaçëm me përfaqësues nga institucionet e sistemit të drejtësisë (KLP, KLGJ, ILD, GJL, PP), nën kryesimin e Ministrisë së Drejtësisë, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e misionit të asistencës teknike të partnerëve tanë ndërkombëtar Euralius dhe OPDAT.

4. Ligji është në përputhje me rendin e brendshëm kushtetues dhe ligjor. Amendimet e propozuara mbështeten në nenet 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Projektligji është në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës, i cili përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

5.Ky ndryshim ligjor vjen në vazhden e ndryshimeve të nevojshme të kryera në paketën e reformës në drejtësi me qëllim adresimin e çështjeve të identifikuar si problematike gjatë zbatimit të tyre. Një ndër këto çështje është edhe paga dhe trajtimi financiar e Drejtorit dhe oficerit të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit për të cilat nuk ka prashikime të posaçme.

6.Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës rezulton se fusha që rregullon ky ligj nuk përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm sa i përket shumicës, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

Ndryshimi në ligjin nr. 95/2019, lidhet me shfuqizimin e pikës 4 të nenit 30 të këtij ligji pasi tashmë paga dhe përfitimet e tjera financiare të oficerit të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit rregullohen në dispozitat e ligjit të posaçëm mbi këtë strukturë, pra në ligjin nr. 95/2016

“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Dispozita aktuale e nenit 30, pika 4, parashikon se paga e oficerit të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit është 20 % më e lartë se paga e oficerit të Policisë Gjyqësore të seksioneve, e llogaritur mbi pagën bruto fillestare oficerit të Policisë Gjyqësore të seksionit. Ndërkohë trajtimi financiar ku përfshihet paga dhe përfitimet e tjera financiare të oficerit të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit përcaktohet në ndryshimet e kryera në ligjin nr. 95/2016.

Përmes shfuqizimit të pikes së mësipërme do të shmanget konflikti i mundshëm midis dispozitave të këtyre ligjeve dhe normimi i përfitimeve financiare të oficerëve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit në ligjin organik përkatës.

Qëllimi i ligjit është shfuqizimi i pikës 4 të nenit 30 të ligjit nr. 95/2019 me qëllim qartësimin dhe shmangien e konfliktit të normave ligjore të legjislacionit sa i përket pagës së oficerit të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) e cila përcaktohet në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Termi “Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar” (SPAK) përdoret për t’iu referuar Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Njësisë së Posaçme Hetimore, e cila emërtohet “Byroja Kombëtare e Hetimit”. BKH është strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

Ndryshimet në ligjin nr. 95/2016 kanë si qëllim rregullimin e trajtimit financiar të tyre por nga ana tjetër keto ndryshime prekin edhe ligjin nr. 95/2019. Për këtë arsye nevojitet të shfuqizohet pika 4 e nenit 30 të këtij ligji.

IV.PËRFUNDIM

Në përfundim të pyetjeve dhe diskutimeve, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm **vendosi rrëzimin e Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13037, datë 19.04.2021**, “Për kthimin e ligjit nr. 48/2021 “Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore””, dhe ia përcjell raportin për votim seancës plenare.

RELATORE

ELENA XHINA

KRYETARI

ULSI MANJA